



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_094_2008
Nr.i Referencës ERO/CPD_D_69_01_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe proceset e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE: ZRRE/DMK_V_69_01_08 të datës 15 janar 2008;
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 25 shkurt 2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit z. Aqif Mehdiu (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 202468) nga Komorani, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori me datë 12 korrik 2007 iu ka drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me numër regjistrimi 93/07 2007 duke apeluar përgjigjen e KEK Sh.A datës 20 qershor 2007 e me numër të referencës DPR – CO1 – 04 lidhur me ankesën e tij për faturimin pa matje – paushall para muajit 05/2006.
2. Me datë 02 qershor 2006 me anë të Procesit nr. 5 mbi heqjen dhe ndërrimin e numëruesit për bazhdarim KEK Sh.A ka bërë regjistrimin e njehsorit të konsumatorit të lartpërmendur ku është hequr njehsori i vjetër me nr. 3278740 dhe është vendosur njehsori i ri me nr. 12380165 me gjendje T1= 000009/000009 kWh dhe T2= 000003/000083 kWh. Në procesin nr. 5 poashtu ceket se më parë është faturuar paushall pasi që shtëpia është dëmtuar gjatë luftës.
3. KEK Sh.A e ka ngarkuar konsumatorin e lartpërmendur me një borxh me anë të faturimit pa matje - paushall pasi që në atë shifër më herët ka pasur shpenzim të energjisë elektrike.
4. Me datë 18 maj 2007 konsumatori iu ka drejtuar KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë me një ankesë lidhur me faturimin pa matje – paushall para muajit 05/2006 ngase sipas deklaratës së konsumatorit ai nuk ka banuar në shtëpinë e tij. Poashtu sipas deklaratës së konsumatorit në shtëpinë e tij ka qenë një person tjetër duke banuar i cili edhe e ka bërë këtë shpenzim.



5. Me datë 20 qershor 2007 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se shifra nr. 202468 e me numër njehsori 12380165 ka borxh. KEK Sh.A ka evidencë për shpenzimin e energjisë elektrike në atë njehsor, ndërsa sa i përket faturimit pa matje – paushall theksohet se është bërë pasi nuk ka pasur njehsor elektrik të regjistruar.
6. Pas kësaj konsumatori iu është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke u ankuar në përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 20 qershor 2007 me numër të referencës DPR – CO1 – 04 lidhur faturimin pa matje – paushall para muajit 05/2006.
7. Me datë 15 janar 2008 DMK në ZRRE ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori dhe ka vendosur ta refuzojë konsumatorin.
8. Me datë 25 shkurt 2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK të ZRRE-së në Bordin e ZRRE-së.

Andaj për arsyet e paraqitura më lart, Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta refuzojë konsumatorin si në arsyetimin e paraqitur në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar